



RELACION TEKNIK

MBI

PASARELËN METALIKE NË HYRJE TË KALASË SË LEZHËS



Punoi: Elson LAQJA

Oltion CUNI

Fatjon MLLOJA

Sabrina KUÇI

MIRATOHET

PËR K.K.T.K.M.

SEKRETARI


Kiara XHELILI

SHKODËR NENTOR 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1. TË DHENA TË PËRGJITHSHME, VENDODHJA DHE ARRITSHMËRIA.....	3
2. PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK.....	3
3. RILEVIME TË GJENDJES EKZISTUESE... ..	4
4. FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE... ..	5
5. GJENDJA EKZISTUESE E MONUMENTIT... ..	10
6. NDËRHYRJET QË PROPOZOHEN... ..	12

Vendodhja




Objekti pozicionohet në hyrje të kalasë së Lezhës dhe bën të mundur kalimin e vizitoreve për në kala. Ajo ngrihet sipër disa rrënojave arkeologjike (varreza), ku aktualisht rezulton të jenë kryer gërmime arkeologjike dhe bashkon dy segmentet e rrugës që të ngjitet në kala. Ura është projektuar në vitin 2012 si pjesë e një financimi madhor që fondi i zhvillimit ka bërë për qytetin e Lezhës, në kuadër të restaurimit të kalasë.

Analiza Arkitektonike

Ura prej druri ka një gjatësi prej 27 m dhe gjerësi prej 2.5 m. Ka një konstruksion druri e mbështetur në plintusa me blloqe betoni.

RILEVIME TE URËS SË VJETËR PREJ DRURI



Rilevime të pasareles së vjetër prej druri

FOTO TË GJENDJES EKZISTUESE (Nëntor 2025)















GJËNDJA E KONSERVIMIT

Nga inspektimi në vend nga ana e specialistëve të DRTK, u konstatua se ura prej druri në hyrje të kalasë së Lezhës nuk ekziston më. Ura e vjetër paraqitej me probleme konstruktive, degradim të elementëve drusorë të strukturës mbajtëse e jo vetëm. Vërehej dëmtim i dyshemesë prej druri si dhe mungesë të elementëve të saj. Gjithashtu tepër të degraduar paraqiteshin edhe parmaket prej druri ku në disa pjesë kishte mungesë të tyre. Për sa më sipër janë marrë masat e nevojshme të menjëherëshme për ndërhyrje restauruese me qëllim sigurimin e jetës së vizitorëve dhe mundësimin e hyrjes për në kala. Si pasojë e këtyre masave është miratuar projekti i pasarelës metalike në hyrje të kalasë së Lezhës me Vendimin Nr. 183 dt 02.06.2022 nga KKTKM. Sot ura e vjetër, në gjendjen e sipërciuar, **nuk ekziston më** dhe është i nevojshëm rishikimi i projektit të miratuar në vitin 2022. Duhet thënë se projekti i miratuar në vitin 2022 nuk është zbatuar dhe për këtë arsye po hartojmë projektin e rishikuar të urës duke u bazuar në projektin e miratuar.





Paraqitja në plan e urës së vjetër prej druri _evidentime të problematikave




Pamje balllore e urës së vjetër së drurit _evidentime të problematikave

Kemi propozuar që të ndërtohet një pasarelë me profile metalike e cila do t'i mbizotërojë më gjatë kohës. Pasarela e re metalike do të mbështetet mbi plintat ekzistues prej betoni në mënyrë që të mos të preket nëntoka dhe do të përshtatet që të lidhet me lartësinë e kuotës së rrugës. Në ato vënde ku plintat e betonit rezultojnë më të ulët, do të plotësohen në lartësi në mënyrë që të unifikohet niveli i pasarelës metalike me rrugën.




Prerje terthore





Prerje gjatesore

(detaj i bashkimit të pasarelës me rrugën ekzistuese)




Detaje konstruktive



Profil IPE

h = 100 mm
b = 55 mm
a = 4.1 mm
e = 5.7 mm
r = 7 mm
Pesha = 8.1 kg/ml



Profil UNI

h = 50 mm
h = 50 mm
e = 5 mm
r = 7 mm
Pesha = 3.77 kg/ml

